



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për mediumet-

Shkup, 11.01.2023

### A është siguruar menaxhim i mirë me sistemet për ujitje?

*Politikat e miratuara, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga ushtruesit dhe organet kompetent të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave nuk sigurojnë përdorim racional dhe efikas të ujit për ujitje dhe menaxhim të mirë me sistemet për ujitje*

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temën „Përdorimi i ujit për ujitje” në pajtim me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022, me qëllim ti përgjigjet pyetjes: „A është siguruar menaxhim i mirë me sistemet për ujitje?”.

Është konstatuar se politikat e miratuara, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga ushtruesit dhe organet kompetent të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave **nuk sigurojnë** përdorim racional dhe efikas të ujit për ujitje dhe menaxhim të mirë me sistemet për ujitje.

Pjesa më e madhe e fondeve në dispozicion nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut **92,2 milion euro** dhe nga kreditë **193 milion euro**, janë të dedikuara për ndërtimin e hidrosistemeve shumëpërdorimëshe dhe rikonstruksioni i sistemeve për ujitje, njëkohësisht në pjesën të madhe është shpërfillur mirëmbajtja e vazhdueshme të sistemeve ekzistuese të vjetërsuara dhe pjesërisht jofunksionale, për këtë arsye **2/3 nga sipërfaqja bujqësore ujitet jashtë sistemeve ose nuk faturohen**, që ndikon në të ardhura më pak të realizuara të ushtruesve të veprimtarisë së ekonomisë së ujërave dhe të Buxhetit të shtetit, sepse për ujitje të tillë nuk arkëtohet kompensimi i ujit, dhe as kompensimi për të drejtën e ujit për ujitje.


Nga ana tjetër për shkak të fillimit të aktiviteteve **jo me kohë dhe dinamikës së ulët**, janë paguar provizione për mjetet e papërdorur nga kreditë në shumë prej **272 mijë euro**.

Plotësuese **çmimet** në bazë të të cilave faturohen shërbimet e ujitjes **nuk sigurojnë** qëndrueshmëri, respektivisht mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtje të vazhdueshme të sistemeve dhe ngarkesa proporcionale të përdoruesve, ndërsa mënyra e vendosur e faturimit nuk siguron arkëtim dhe përcaktim të plotë të kompensimeve.

Në **SH.A Ekonomia e Ujërave** në vitet 2019 dhe 2021 në menyrë disproporcionale janë planifikuar sasi të **larta** të ujit, ndërsa janë **treguar** edhe sasi më të mëdha të konsumuara, dukshëm mbi atë që **nevojitet realisht për ujitjen** e sipërfaqeve të planifikuara, që sjellë në humbje të ujit gjegjësisht **humbje e të ardhurave** prej më së paku **3.6 milionë euro**, ndërsa në të njëjtën kohë **shterimi i tepërt i burimeve ujore**, duke pasur parasysh se ujitja është konsumatori më i madh i ujit në vend.



Nga revizioni i kryer është konstatuar se rregullativa ligjore është **zbatuar në mënyrë jo të plotë dhe pa shprehur**, gjegjësisht janë përcaktuar **kompetencat** për më shumë institucione për aspekte të ndryshme të menaxhimit me ujërat pa mënyrën të **rregullt** komunikimi të ndërsjellët. **Modeli i centralizuar** aktual i menaxhimit nuk i ka dhënë rezultatet e pritura dhe **nuk është siguruar** ekonomizim, konsumim, funksionim dhe mirëmbajtje ekonomike e sistemeve për ujitje.

Është konstatuar **ndarja e pabarabartë e mjeteve dhe shkallës së ulët të realizimit** të projekteve nga **Plani për investime në infrastrukturën e ekonomisë së ujërave për periudhën 2015-2025** me të cilën janë paraparë investime në ekonominë e ujërave në vlerë prej **19,88 miliardë denarë ose mbi 323 milion euro**. Nga gjithsej investime të kontraktuara në vlerë prej 5,7 miliardë denarë, deri më qershor të 2022 janë paguar 3,3 miliardë denarë, që është 16% nga të parashikuara.




Gjithashtu është konstatuar se në **mungesë të kritereve objektive për zgjedhjen** e projekteve të cilët do të financohen nga mjetet buxhetore, është dhënë prioritet realizimit të projekteve për ndërtimin e tri rajoneve, ndërsa për të tjerat nuk janë siguruar mjetet, ndërsa për rehabilitimin e digave dhe sistemeve për ujitje janë dedikuar vetëm **1%** nga mjetet e siguruar.

**Projekte të financuara nga mjetet buxhetore për investime kapitale në infrastrukturën e ekonomisë së ujërave**  
Plani 2015-2025



Është konstatuar **realizimi i ngadalësuar dhe përmbushje jo e plotë** e qëllimeve për ndërtim dhe rekonstruksion të infrastrukturës së ekonomisë së ujërave në vend me mjete nga huat te bankat e jashtëm ose institucionet ndërkombëtare financiare, me të cilët janë lidhur kontratat për hua në shumë prej **11,8 miliardë denarë ose përafërsisht 193 milion euro**.

**Kontrata të lidhura për hua**




**Sistemet për ujitje** janë të vjetërsuar dhe për shkak të periudhës së gjatë të mirëmbajtjes së parregullt të njëjtit fundosen dhe gjenerojnë humbje të mëdha të ujit. Edhe kundër përpjekjeve të parakohshme të cilat i bëjnë punonjësit në filialet, në kushte të mungesës së mjeteve financiare, personalit, mekanizmave, pajisjeve dhe pjesëve rezerve nuk janë

në gjendje ti realizojnë aktivitete e planifikuara për mirëmbajtjen dhe të sigurojnë funksionim të plotë të sistemeve.

Sipas **Komisionit për digat**, është e nevojshme riparimi urgjent i disave nga digat me të cilat menaxhon SH.A Ekonomia e Ujërave, të cilët një periudhë të gjatë nuk janë mirëmbajtur dhe riparuar dhe nuk është ndjekur siguria dhe stabiliteti i tyre, ndërsa disa nga ato janë lëshuar deri në nivelin që i bën të **dëmtuar me rrezik të papranueshëm për mjedisin**.

Me programet buxhetore janë ndarë mjete për investimet tjera në infrastrukturën e ekonomisë së ujërave, **ku shkalla e realizimit të aktiviteteve të planifikuara është shumë e ulët**, për shkak të zbatimit joefikas të procedurave për prokurime publike nga ana e SH.A Ekonomia e Ujërave.

Me revizionin është konstatuar se **nuk ka informacione sinkronizuese** për shkallën e përdorimit dhe për nevojat reale të sistemeve për ujitje. Nga ana tjetër, gjendja e keqe e sistemeve për ujitje ka sjellë deri në nivelin e përdorimit të pamjaftueshme, ndërsa në të njëjtën kohë 2/3 e sipërfaqes bujqësore ujitet jashtë nga të tjerët ose nuk janë faturuar nga ushtruesit e veprimtarisë së ekonomisë së ujërave, që është e pamundur arkëtimi i kompensimeve për të drejtën e ujit dhe ujitjes.




**Nuk ka evidencë të kompletuar dhe azhurnuar** të lejeve të lëshuara për të drejtën e ujit, një sasi e madhe nga uji për ujitje përdoret pa siguruar leje, dhe njëherazi **nuk ka sistem për ndjekjen** e gjendjes së konsumimit dhe gjendja e bilancit të ujit në vend, që veçanërisht është theksuar me rezervat e ujit nëntokësorë. SH.A Ekonomia e Ujërave ka siguruar **13 leje** për të drejtat e ujit të cilat i referohen vetëm për një pjesës të sistemeve dhe akumulacioneve më të mëdha për ujitje, dhe në të njëjtën kohë ka siguruar **64 leje**



për nxjerrjen e rërës, zhavorreve dhe gurëve nga lumenjtë, që udhëzon në **prioritet të përcaktuara joadekuate**.

SH.A Ekonomia e Ujërave duke përfshirë edhe vitin 2021 nuk ka kryer pagesë në dobi të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të kompensimit për përdorimin e ujit në më shumë mënyra, në shumën totale prej **30,15 milion denarë**, për çka për disa nga këto detyrime me MMJPH-së është lidhur Kontratë për pagesën të gjobës me kusht, në pajtim me të cilën janë paguar 2,17 milion denarë, por edhe më tej nuk kryet pagesa e detyrimeve të bëra aktualisht për kompensimet.

SH.A Ekonomia e Ujërave në vazhdimësi **planifikon mbi 7.000m<sup>3</sup> ujë për hektar sipërfaqe**, edhe pse norma për ujitjen e kulturave të cilët kërkojnë ujitje më intensive është **4.788m<sup>3</sup> ujë për hektar**, ndërsa shumica e kulturave kërkojnë më pak ujë. Nga ana tjetër, në vazhdimësi theksohet se rreth **20% sipërfaqe më pak nga të planifikuarit**, ndërsa janë treguar disa herë më shumë sasi të ujit të konsumuar nga të planifikuarit për të njëjtën sipërfaqe. Kjo, në pjesën më të madhe është rezultat i **kontrollit të pavendosur** të shpenzimit të ujit, gjendja e keqe në të cilën gjenden sistemet dhe planifikimi joadekuat.



Kompensimi për ujit arkëtohet në **vlerë fikse** sipas kulturës dhe sipërfaqes së lajmëruar, gjegjësisht **nuk mirët parasysh sasia e harxhuar reale** e ujit, kjo gjendje do të thotë se uji i harxhuar më shumë paraqet **humbje**, respektivisht për të njëjtën nuk arkëtohen të ardhurat. Kjo gjendje është theksuar veçanërisht **në vitet 2019-2021** kur janë **harxhuar mbi 451 milion gjegjësisht 92 milion m<sup>3</sup> ujë mbi të planifikuarën**.

Me atë ujë, të llogaritur sipas normës së lartpërmendur në dy vitet do të mund të sigurohej ujitje intensive i **113 mijë hektarëve** shtesë, që të llogaritur sipas çmimi më të ulët prej 2 mijë denarë për hektar, është më së paku **226 milion denarë ose rreth 3.6 milion euro humbe të të ardhurave.**

SH.A Ekonomia e Ujërave ka shuma të larta të kërkesave të pa arkëtuara nga përdoruesit e shërbimeve të tyre dhe **detyrime të pa paguara kundrejt shtetit** të cilat arrinë shumën prej 56,6 milion denarë, si dhe drejt furnizuesve dhe punonjësve. Disa nga ndërmarrjet publike të Ekonomisë së Ujërave, të cilëve hidrosistemet e tyre janë të pa rindërtuara dhe nuk funksionojnë në kapacitet të plotë ballafaqohen me mungesë të vazhdueshme të mjeteve financiare për punë të rregullt dhe për servisim të detyrimeve kreditore, për këtë arsye përdorin mjete nga Buxheti i shtetit. Në të njëjtën kohë ushtruesit e veprimtarisë së ekonomisë së ujërave realizojnë humbje të vazhdueshme nga puna të cilët për tri vitet e fundit shuma është mbi 1,3 miliardë denarë ose mbi 20 milion euro.

**Menaxhimi dhe gjendja e keqe** e sistemeve, sjellë edhe deri në ngarkesë shtesë financiare të ofruesit të shërbimeve për ujitje për arsye të pagesës së dëmeve dhe padive nga përdoruesit në bazë të tharjes ose vërshimeve të plantacioneve dhe mbjelljeve.

Në vitin 2022 NP Strezhovë ka paguar **rreth 61 milion denarë** në bazë të demit ose **përafërsisht 1 milion euro**, ndërsa SH.A Ekonomia e Ujërave zhvillon procedura gjyqësore në bazë të dëmeve në shumë prej **142 milion denarë ose përafërsisht rreth 2,3 milion euro.**

Për shkak të **kapacitetit të pamjaftueshëm** të institucioneve kompetente për mbikëqyrje inspektuese dhe profesionale nuk munden të përcaktohen në kohë mosrespektimi i rregullativës ligjore gjatë përdorimit të ujit për ujitje dhe ndërmarrin masa për tejkalimin e tyre.

Me revizion është përfshirë periudha **prej vitit 2019 deri vitin 2021**, ndërsa janë treguar edhe gjendjet të cilat kanë ndodhur më parë dhe më pas deri ditën e njoftimit për revizionin e kryer.

**Kontaktet për shtyp:**

**Albiona Mustafa Muhaxhiri** +389 72228 203

[albiona.mustafa@dzt.gov.mk](mailto:albiona.mustafa@dzt.gov.mk)

**Mijallçe Durgutov** +389 70 358 486

[mijalce.durgutov@dzt.gov.mk](mailto:mijalce.durgutov@dzt.gov.mk)

**Martin Duvnjak** +389 75 268 517

[martin.duvnjak@dzt.gov.mk](mailto:martin.duvnjak@dzt.gov.mk)